

QENDRA KOMBËTARE E INVENTARIZIMIT TË PASURIVE KULTURORE

KOMISIONI I PËRHERSHËM I VLERËSIMIT

PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË OBJEKTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË PRONËSI PRIVATE, DHE DHËNIA E LEJES PËR LËVIZJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pikave 4 e 5 të nenit 9 të ligjit 9048, datë 07.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndyshuar, si dhe referuar **Vendimit Nr.795, datë 26.11.2003** “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyren e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të objekteve të Trashëgimisë Kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedura të vlerësimit të këtyre objekteve”, procedurat e ndjekura janë:

DOKUMENTACIONI

1. Vlerësimi, i objekteve të Trashëgimisë Kulturore, në pronësi private, të luajtshme, bëhet pas kërkesës me shkrim të subjektit të interesuar, person fizik ose juridik, drejtuar Ministrisë së Kulturës.

Kërkesa shoqërohet me:

- a) Kopjen e formularit standard të aplikimit, të plotësuar në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore;
- b) Pasaportën përkatëse për çdo objekt, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore;
- c) Për personat juridike, dokumentacionin e plotë ligjor të regjistrimit si person juridik në gjykatë, organet tatimore dhe organe të tjera të specializuara, vërtetimet nga gjykata, prokuroria, përbarimi dhe organet tatimore, që vërtetojnë se personi i interesuar nuk ka detyrime ndaj tyre, si dhe nuk është në proces gjyqësor, civil apo penal;
- ç) Për personat fizikë, fotokopjen e pasaportës ose kartën e identitetit dhe adresën e saktë të vendbanimit, si dhe vërtetimet nga gjykata, prokuroria, përbarimi dhe organet tatimore, që vërtetojnë se personi i interesuar nuk ka detyrime ndaj tyre;
- d) Mandat pagesën përkatëse nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, sipas numrit të objekteve që kërkohet të dalin jashtë vendit.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar jo më shumë se 3 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

